



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPËSTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 11.06.2021

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të datës 03.06.2021, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik **1."N.T.SH. Atom - Med" SH.P.K. dhe 2." Biohit MDS SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore"**, me Nr. të Prok: **632-21-3003-1-2-1**, nxjerr:

V E N D I M

- II. **1. APROVOHEN** si pjesërisht të bazuara kërkesat për ri-shqyrtim të Operatorve Ekonomik **1."N.T.SH. Atom - Med" SH.P.K. dhe 2. " Biohit MDS SH.P.K**, të dt.03.06.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore"**, me Nr. të Prok: **632-21-3003-1-2-1**, kundër **Dosjes së tenderit**, te AK –së, të datës 25.03.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. ANULOHET** aktiviteti i prokurimit: **"Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore"**, me Nr. të Prok: **632-21-3003-1-2-1**, i publikuar me datë: **25.03.2020**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit dhe të bëjë ri-shpalljen e tij për të gjitha lotet.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Ar sy e t i m

Meqë Operatorët Ekonomik **1. "N.T.SH. Atom - Med" SH.P.K. dhe 2. " Biohit MDS SH.P.K,** kanë parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore", me Nr. të Prok: 632-21-3003-1-2-1.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 11.06..2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti kontraktues pas rishikimit të dokumenteve ka konstatuar se disa nga pikat ankimore të dy Operatorëve ekonomik të lartpërmendur janë të bazuara.

Për shkak të kërkesave të shumta për sqarime shtesë të Operatoreve ekonomik të cilat kanë ofertuar dhe paqartësive të specifikacioneve, Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit "Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore", me Nr. të Prok: 632-21-3003-1-2-1, dhe të bëjë ri-shpalljen e tij për të gjitha lotet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv,

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivit të Komunës

z.Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

